ADMINISTRATA DOGANORE
Dega e Doganës Kapshticë
Nr. 53/5 Date 16.04.2024 Fletë
PROTOKOLLI

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
Nr. 9271 Prot.
Datë,më 24.4.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE**
**DEGA E DOGANËS KAPSHTICË**

**Nr.** 53/5 **prot** **Kapshticë, më** 16 / 04 **/ 2024**

**Lënda:** **Kërkesë për njoftim/shpallje publike nëpërmjet afishimit**

**Drejtuar:** **DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE, TIRANË**
**TIRANË**
**DREJTORIA E SHERBIMEVE MBESHTETESE**

**Të nderuar!**

Në zbatim të ligjit 102/2014 date 31/07/2014 "Kodi Doganor i Republikes se Shqiperise", nenin 96 dhe pikës 4 të nenit 162 të Ligjit Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodit të Procedures Administrative i Republikës së Shqipërisë", *4. "...organi publik publikon aktin në faqen e tij të internetit dhe ... "* neni 273 e vijues, Udhezimin Nr 15 date 03/12/2018 "*Per evidentimin kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve doganore dhe te akcizes*", duke u mbeshtetur ne nenet 6/3 te Ligjit 102/2014 date 31/07/2014 "Kodi Doganor i Republikes se Shqiperise, nenet, 17/1 te ligjit 9917 datë 19.5.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", ligjit 10279 date 20/05/2010 "Per kundravajtjet administrative", me qëllim plotësimin e detyrimit për njoftim të vendimit te marë, për efekt të vijimit të procedurave administrative, kerkohet të behet njoftimi nëpërmjet shpalljes parnë faqes së Web-it , për subjektin në procedurë, te **vendimit bashkelidhur**, per efekt te vijimit te procedurave administrative.

**Subjekti:** **Shtetase Sevasti Thoma, me banim ne Korce**
**Vendimi:** **58 date 11/04/2024**
**Nxjerre :** **Dega Doganore Kapshtice**
**Detyrim:** **0 leke**
**Penalitet:** **40.000 leke**

**Duke ju falenderuar per mirëkuptimin.**

**KRYETARI I DEGËS DOGANËS KAPSHTICË**

**DRITAN ÇEKANI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË - DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE - DEGA DOGANORE KAPSHTICË

Nr. 60/4 Date 11.04.2024
PROTOKOLLI

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE**
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE**
**DEGA E DOGANËS KAPSHTICË**

**Nr 60/4 Prot** **Date 11 04 2024**

**VENDIM**

**Nr 58 date 11.04 2024**

Ne cilesine e Kryetarit te Deges Doganore Kapshtice dhe njekohesisht te vendimarresit, pasi shqyrtova proces verbalin **Nr 2627/2 date 17/11/2023**(pjese integrale e ketij vendimi)te nenpunesve qe kane sherbyer ne Pike Dalje ne date 25/10/2023, pas administrimit te akteve si edhe pas plotesimit te procedures per njoftim me shpallje, akte dhe procedure qe lidhen me mosdeklarimin dhe mospermbushjen e detyrimeve, te percaktuara ne nenin 17/1 teligjit 9917 datë 19.5.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", te shtetases **Sevasti Thoma** e datelindjes 19/06/1969 identifikuar me pshaporte kanadeze GL466078 e bija e Dhimitraq, me adrese ne Bulevardi "Gjergj Kastrioti", P. 16, H 2, Ap 4, Njesia Administrative Korçë, Korçë.

**KONSTATOVA:**

Nga proces verbali me **Nr 2627/2 date 17/11/2023**(pjese integrale e ketij vendimi)te nenpunesve qe kane sherbyer ne Pike Dalje ne date 25/10/2023, pas administrimit te akteve si edhe pas plotesimit te procedures per njoftim me shpallje, akte dhe procedure qe lidhen me mosdeklarimin dhe mospermbushjen e detyrimeve, te percaktuara ne nenin 17/1 teligjit 9917 datë 19.5.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", te shtetases **Sevasti Thoma** e datelindjes 19/06/1969 identifikuar me pshaporte kanadeze GL466078 e bija e Dhimitraq, me adrese ne Bulevardi "Gjergj Kastrioti", P. 16, H 2, Ap 4, Njesia Administrative Korçë, Korçë, eshte konstatuar se shtetesja, ne date 25/10/2023 ora 10:15, ne Piken e Daljes se Deges Doganore Kapshtice, eshte konstatuar me shumen prej *30.000 dollare kanadeze te padeklaruara*, si edhe *2.700 euro, te padeklaruara*, fakt per te cilin ligji 9917/2008 "Per parandalimin e pastrimit te parave dhe financimin e terrorizmit" , i ndryshuar, neni 17/1 parashikon aplikim te saknkionit per faktin e mosdeklarimit te vlerave monetare qe mbahen, mbarten.

Dispozita ligjore parashikon shprehimisht se "1. Çdo person, i cili hyn në/ose largohet nga territori i Republikës së Shqipërisë, është i detyruar të deklarojë shumat në të holla, çdo lloj instrumenti të negociueshëm të mbajtësit, metalet ose gurët e çmuar, sendet me vlerë dhe objektet antike, duke filluar nga shuma 10 000 euro ose kundërvlerën e saj në monedha të tjera, qëllimin e mbajtjes së tyre, si dhe të paraqesë dokumente justifikuese përkatëse.

4. Në rast kur autoritetet doganore kryesisht ose në bashkëpunim me strukturat kompetente të Policisë së Shtetit konstatojnë mosdeklarimin, sipas pikës 1, të këtij neni, paralelisht me trajtimin e rastit, sipas dispozitave të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, vendosin gjobë, e cila për herën e parë në varësi të shumës së padeklaruar është në shumë fikse, dhe për raste të përsëritura do të përllogaritet si përqindje ndaj vlerës së padeklaruar si më poshtë:

a) për shumat nga 10 000 - 19 999 euro ose kundërvlerën e tyre në monedha të tjera të huaja, gjoba është në shumën 20 000 (njëzet mijë) lekë për herën e parë, 10 % të vlerës së padeklaruar për herën e dytë, si dhe 30 % të vlerës së padeklaruar për rastet e tjera; b) për shumat nga 20 000 – 49 999 euro ose kundërvlerën e tyre në monedha të tjera të huaja, gjoba është në shumën 40 000 (dyzet mijë) lekë për herën e parë, 20 % të vlerës së padeklaruar për herën e dytë, si dhe 40 % të vlerës së padeklaruar për rastet e tjera; c) për shumat mbi 50 000 euro ose kundërvlera e tyre në monedha të tjera të huaja, gjoba është në shumën 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë për herën e parë, 30 % të vlerës së padeklaruar për herën e dytë, si dhe 50 % të vlerës së padeklaruar për rastet e tjera.

Pra ne varesi te shumes se konstatuar te padeklaruar nga shtetasi, ligji ka parashikuar sankksionin administrative dhe masen e sanksionit.

Ne rastin me shqyrtim eshte konstatuar mosdeklarimi i vleres 30.000 dollare kanadeze te padeklaruara, si edhe 2.700 euro, te padeklaruara, passjell aplikimin e sanksionit administrativ ne masen 40.000 leke. Ndaj duke u mbeshtetur ne nenet 6/3 te Ligjit 102/2014 date 31/07/2014 "Kodi Doganor i Republikes se Shqiperise", nenet, 17/1 te ligjit 9917 datë 19.5.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative", ligjit 10279 date 20/05/2010 "Per kundravajtjet administrative".

**VENDOSA**

**1)**Subjekti/shtetesja **Sevasti Thoma** e datelindjes 19/06/1969 identifikuar me pshaporte GL466078 me adrese ne Bulevardi 'Gjergj Kastrioti', P. 16, H 2, Ap 4, Njesia Administrative Korçë, Korçë, te ndeshkohet me penalitet ne masen **40.000**(dyzetmije leke).
**2)** Kunder ketij vendimi mund te ushtrohet ankim gjyqesor para Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Tirane ne afatin 30 ditor nga marrja dijeni per vendimin, ne referim te ligjit 10279 datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative".

**KRYETARI I DEGES SE DOGANES KAPSHTICE**
**DRITAN ÇEKANI**

REPUBLIKA E SHQIPERISE - MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE - DREJTORIA E PERGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA DOGANORE
KAPSHTICE